

**STATUT/AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"HAYIRLI DANISMANLIK "**

Ne baze te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare"

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME  
FORMIMI I SHOQERISE  
NENI 1**

1 . Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK "shpk me seli ne adresen Tirane Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H9 Tirane, formohet nga ortaku themelues:

**Z.MERYEM TOPTAŞ HAYIRLI**, i datelindjes 05.04.1979, lindur ne Sivas , banuese ne Mamak /Turqi, madhore, me zotesi te plote juridike per te vepruar, me numer identifikimi personal U36179212 referuar ne vazhdim si Ortaku i Vetem.

E cila me vullnetin e saj te lire dhe te plote dhe ne perputhje me ligjin "PER SHOQERITE TREGTARE", REGJISTRIN TREGTAR si dhe AKTIN E THEMELIMIT ka vendosur te destinoje ne kete sipermarrje kapitalin e tij vendas, me qellim qe te perfitoje te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e shoqerise, si dhe te perballojne humbjet deri ne kufirin e e vleres se kontributit ne kapitalin themeltar.

2. Shoqeria e ushtron veprimtarine ne baze te ekonomise se tregut te lire.

3. Shoqeria eshte person juridik dhe fiton zotesine per te vepruar duke u pajisur me lejen e ushtrimit te te profesionit nga zyra e qendres kombetare te regjistrimit (QKB)te rajonit perkates.

4. Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK " shpk fiton personalitet juridik nga dita e regjistrimit te saj prane zyres se qendres kombetare te regjistrimit(QKR).

**FORMA, EMERTIMI  
NENI 2**

1. Shoqeria Tregtare eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me pergjegjesi te kufizuar.

2. Emertimi i Shoqerise eshte "HAYIRLI DANISMANLIK " shpk.

3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe personi juridik te shtoje ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

4. Shoqeria zoteron dhe perdor marken, simbolin dhe vulen e saj me emrin "HAYIRLI DANISMANLIK " ose "HAYIRLI DANISMANLIK " ose "HAYIRLI DANISMANLIK ". Keto nuk mund te zoterohen apo perdoren nga pale te tjera si vendas apo te huaj pa miratimin me shkrim te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie.

**SELIA  
NENI 3**

Selia e shoqerise "HAYIRLI DANISMANLIK " shpk ndodhet ne Tiranë, Kashar ,Yrshek Godina nr 25, H9 Tirane Albania. Shoqeria mund te krijojë filiale, dege e perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ashtu dhe jashtë territorit të saj sipas nevojave. Selia mund te ndryshohet/transferohet ne cdo vend tjeter me vendim te Asamblese se Ortakut/eve, i cili ratifikohet nga mbledhja e afert e asamblese se zakonshme. Keto vendime depozitohen ne Regjistrin Tregtar.

**NENI 4**



## **KOHEZGJATJA**

1. Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK" shpk do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet duke perfshire edhe edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasoje krijimin e nje personaliteti juridik te ri.

## **OBJEKTI**

### **NENI 5**

Shoqeria "HAYIRLI DANISMANLIK" sh.p.k., ka si objekt veprimtarie:

- Kryerjen dhe zhvillimin e te gjitha veprimtarive dhe akteve qe lejon legjislacioni edhe aktet nenligjore ne fuqi, ne fusha te ndryshme te arsimit dhe keshillimit psikologjik , dhe hapje te qendrave arsimore dhe keshilluese ..., etj., si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise ashtu edhe ne territorin Nderkombetar.
- Gjithashtu, ushtrimi i cdo lloj operacioni tjetër legal qe mund te jete e nevojshme per Shoqerine si psh. Sherbime kompjuterike teknologjike, sherbime sigurie, programime, media, shitje online, tregti tekstile, dizajn, oraganizime, bujqesi , turizem, marketing, import eksport dhe tregti te jashtme.

### **NENI 6**

Shoqeria Tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK" sh.p.k., nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomike-tregtare qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj. Ky kapital depozitohet sipas ligjit. Ne librin e llogarise te Shoqerise krijohet fondi themeltar ku shenohet kapitali i ortakeve.

### **NENI 7**

#### **KAPITALI**

Kapitali themeltar eshte 100.000(njeqindmije) Leke, i ndare ky ne 1 kuota, nga ku 100% e kapitalit i perket Z.MERYEM TOPTAŞ HAYIRLI.

### **NENI 8**


Shoqeria ka te drejte te krijojë fondin rezerve dhe fonde te tjera te vecanta te financimit per zhvillimin ekonomik dhe tregtar.

### **NENI 9**

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi dhe rregullimi i cdo fondi te vecante percaktohen nga ortaket sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjithshme te shoqerise dhe ne pergjithesi cdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.

### **NENI 10**

1. Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK" sh.p.k., eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te marre, te perdore, te bleje apo shese dhe te shfrytezoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike, apo kontabiliteti dhe juridike paguhen vetem nga fondet e shoqerise.



2

#### **NENI 11**

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 dhjetor te cdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e vecanta te ortakeve te hartuara nga ortaket dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen me vendim te ortakeve.

#### **NENI 12**

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

#### **NENI 13**

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithë ndryshimet qe ai mund te kete pesuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

#### **NENI 14**

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e ortakeve.

#### **NENI 15**

Zmadhimi i kapitalit themeltar me ane te kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me vendimin e ortakeve mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

#### **NENI 16**

##### **ORTAKERIA**

Ortaket e shoqerise tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK" sh.p.k., gezojne te gjitha te drejtat dhe marrin persiper te gjitha detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacion e republikes se shqiperise, ne aktin e themelimit dhe ne satutin e shoqerise.

#### **NENI 17**


##### **TE DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKEVE.**

1. Te marrin pjese ne mbledhjet e asamblese se ortakeve duke ushtruar te drejten e votes.
2. Te paraqesin pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit.
3. Te informohen mbi pergatitjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel.
4. Te perfitojne nga fitimi i shoqerise.
5. Te kerkojne prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara.

#### **NENI 18**

##### **ADMINISTRIMI I SHOQERISE**

1. Shoqeria do te administrohet nga nje Administrator i zgjedhur nga Ortaku i Shoqerise. Si Administrator i shoqerise do te zgjidhet **MERYEM TOPTAŞ HAYIRLI**, me nje afat 5 vjecar, e cila perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet. Administratori do te kryeje te gjitha veprimet zyrtare te shoqerise.
2. Shoqeria, ne te ardhmen mund te administrohet edhe nga nje Administrator tjetër, i cili emerohet me Vendim te Ortakut/eve.



3. Administratori, mund t'i delegoje kompetencat e tij (pjeserisht ose te gjitha) me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
4. Vendimet e ortakeve, evidencohen ne nje rregjister te vecante.

#### **NENI 19**

##### **ASAMBLEJA**

Asambleja e Pergjithshme ka te drejte:

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne statut.
  2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise.
  3. Te vendose per zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit.
  4. Te emeruje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise.
  5. Te shpalle prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqerise.
- Procesverbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

#### **NENI 20**

##### **TE DREJTAT E ADMINISTRATORIT**

Administratori ka keto te drejta.

1. Te mbikeqyre dhe te kontrolloj gjithe veprimtarine e shoqerise.
2. Te perfaqesoj shoqerine ne marredheniet me te tretet, ne administraten publike dhe organet gjyqesore.
3. Te emeruje personelin e domosdoshem.
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise.
5. Te therrase asamblene dhe te vendose rendin e dites.
6. Te hartoje planet e llogarive ekonomike dhe te paraqese ato per miratim asamblese se ortakeve.

#### **NENI 21**

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

#### **NENI 22**

1. Shoqeria "HAYIRLI DANISMANLIK" sh.p.k., mund te emeruje ne vazhdimesi nje ekspert kontabel per nje afat kohor te percaktuar me te drejte rizgjedhje.
2. Emerimi kryhet nga ortaket.
3. Per kompetencat, shkarkimin dhe shperblimin etij zbatohet legjislacioni shqiptar ne fuqi.

#### **NENI 23**

##### **MARREDHENIET E PUNESIMIT**

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet ne baze te kontrates individuale te punes ose kolektive, ne te cilen do te percaktohen te drejtat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin vendas ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me ane te regjistrimit nga ana e punedhenesit ne librin e punes se shoqerise.
3. Largimi nga vendi i punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga administratori. Largimi nga puna lidhet me mbarimin e kontrates se punes, per shkak te shkeljes disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mos marreveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise do te zgjidhen me mirekuptim, ose kur ky i fundit nuk eshte i mundur palet do ti drejtohen gjykates kompetente perkatese.

#### **NENI 24**

##### **BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQERISE**



1. Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK " sh.p.k., me ane te bashkimit mund ti kaloje trashegimine e saj nje shoqerie ekzistuese ose nje shoqerie te re qe ato themelojne dhe qe ushtron te njejtin aktivitet.

2. Shoqeria tregtare "HAYIRLI DANISMANLIK " sh.p.k., me ane te ndarjes mund ti kaloje trashegimine e saj disa shoqerive te tjera ezistuese ose shoqerive te reja.

#### **NENI 25**

##### **PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE.**

1. Shoqeria mund te priset ne cdo kohe dhe per cfare do lloj shkakut, si ne rast falimentimi, privimi te drejtave per te ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktore te tjere qe nuk varen nga ortaket.

2. Shoqeria hyn ne fazen e e likujdimit qysh ne momentin e prishjes se saj.

Per kete, ortaket emerohjne nje ose me shume likujdator.

3. Shoqeria priset ne keto raste:

- Kur nuk mund te permbushet objekti per te cilin eshte krijuar.

- me vullnetin e ortakeve.

- me vendim te gjykates.

- kur mbaron afati i veprimtarise se shoqerise.

#### **NENI 26**

##### **DISPOZITA TE FUNDIT**

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut do te aplikohet ligji "PER SHOQERITE TREGTARE" si dhe legjislacioni ne fuqi.

#### **NENI 27**

Ky statut hyn ne fuqi ditën e regjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtarne qendren kombetare te regjistrimit(QKB).

#### **NENI 28**

Ky statut perpilohet ne 3 kopje origjinale me te njejtën vlere ligjore perktheu **Taulant Anamali** i njohur dhe pranuar nga ortaku.

Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin e shoqerise.

#### **ORTAKU I VETEM THEMELUES**

**MERYEM TOPTAŞ HAYIRLI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË  
NOTER MAJLINDA DEMOLLARI



V2023053790632326704

DATE 08/11/2023  
NR REP 8810



**VËRTETIM NËNSHKRIMI**

Sot, më datë 08.11.2023 (dymije e njetete e tre), vertetoj firmen e ortakut te shoqerise " Hayirli Danismanlik" **Meryem Toptas Hayirli**, shtetase Turke, lindur në Turqi, me adresë Turqi, lindur më 05/04/1979, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Pasaporte Tjeter nr. 30200114764 dhe nr. personal 30200114764. E cila me ka deklaruar se akti eshte nenshkruar prej saj dhe une Unë Noteri/ja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**NOTER**

MAJLINDA DEMOLLARI

NOTERE  
Majlinda E. Demollari  
MPP: 7416060404  
Tel: 06882061560